



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME

INSPEKTORIATI KOMBËTAR I MBROJTJES SË TERRITORIT
DREJTORIA RAJONALE TIRANË

Nr. 35/1 Prot.

Tiranë, më 03.02.2021

Lënda : Kthim përgjigje

Banorëve të Lagjes "Plepat e Brukës", Laknas, Bashkia Kamëz
Av. Dorina Ndreka, Bll. "Vasil Shanto", Rr. "Viktor Eftimiu", P.3, Tiranë

Për dijëni: IKMT Qendër

Rruga "Muhamet Gjollesha", pranë Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit

Në përgjigje të shkresës tuaj Nr.222 Prot., datë 14.01.2021 drejtuar Institucionit tonë, Ju informojmë se:

Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, Drejtoria Rajonale Tiranë, ngriti një grup inspektimi nga Sektori i Inspektimit Pyjor, i cili bëri verifikimet në terren. Pas verifikimit në vend, për problematikën e ngritur nga komuniteti i lagjes "Plepat e Brukes", Laknas-Kamëz, u konstatua se:

Sipërfaqja është një grumbull pyjor i përbërë nga lloje si, plep, akacie, shelgje, rrap, shkurreta etj. Në këtë sipërfaqe nuk u konstatuan prerje drurësh apo gërmime për ndërtim objektësh. Banorët e zonës e kishin rrethuar sipërfaqen pyjore me tela me gjemba, që ta mbronin nga dëmtimet e ndryshme, pasi ajo i mbronte nga grryerjet e Lumit të Tiranës, kur ka rreshje të shumta shiu. Kjo sipërfaqe nuk është pjesë e fondit pyjor kombëtar, por në pronësi publike të bashkisë Kamëz dhe që është ruajtur nga komuniteti i zonës. Nga vetëdeklarimet e banorëve të Lagjes "Plepat e Brukës", që përbëhet nga 30 familje me rreth 200 banorë, sipërfaqen pyjore e kanë ruajtur dhe mirëmbajtur ndër vite, që të mbronin shtëpiat e tyre nga gërryerjet e Lumit të Tiranës. Referuar deklarimeve të banorëve, nga strukturat e Bashkisë Kamëz, nuk janë kryer konsultime me banorët e zonës, për investimet që do të bëheshin në këtë sipërfaqe pyjore.

Sa më sipër, theksojmë se në këtë sipërfaqe pyjore nuk duhet të ketë asnjë ndërhyrje apo prerje të drurëve, pasi rrezikohen banesat e komunitetit të lagjes "Plepat e Brukës", nga prurjet e Lumit të Tiranës. Aktiviteti i propozuar kërkon një studim të mirëfilltë të situatës, gjëndjes reale, si dhe pjesëmarrjen e komunitetit në procesin e hartimit dhe miratimit të projektit.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

DREJTOR I IKMT DEGA TIRANË

Rigers SHEQERI

